

20222513671

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT TË KONTRIBUTEVE TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM SOCIAL

Neni 1

Në Ligjin e Kontributeve të Sigurimit të Detyrueshëm Social (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 142/08, 64/09, 156/09, 166/10, 53/11, 185/11, 44/12, 15/13, 91/13, 170/13, 97/14, 113/14, 180/14, 188/14, 20/15, 48/15, 129/15, 217/15, 190/16, 171/17, 35/18 dhe 247/18) në nenin 4 në pikën) 9 fjalët: “Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë, Fondi i Sigurimit Shëndetësor i Maqedonisë dhe Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: “Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Fondi i Sigurimit Shëndetësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Në pikat 15) dhe 16) fjalët: “Republika e Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: “Republika e Maqedonisë së Veriut”.

Neni 2

Në nenin 6 në paragrafët (1), (3) dhe (4) fjala: “Maqedonia” zëvendësohet me fjalët: “Republika e Maqedonisë së Veriut”.

Neni 3

Në nenin 7 paragrafi (1) në pikat 2), 3) dhe 4) fjalët: “Republika e Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: “Republika e Maqedonisë së Veriut”.

Në pikën 6-a) fjala: “Maqedonia” zëvendësohet me fjalët: “Republika e Maqedonisë së Veriut”.

Në pikën 12) fjalët: “Republika e Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: “Republika e Maqedonisë së Veriut”.

Neni 4

Në nenin 8 në pikën 5) fjalët: “Republika e Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: “Republika e Maqedonisë së Veriut”.

Neni 5

Në nenin 10 në pikën 2) fjalët: “Republika e Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: “Republika e Maqedonisë së Veriut”.

Në pikën 4-a) fjala: “Maqedonia” zëvendësohet me fjalët: “Republika e Maqedonisë së Veriut”.

Në pikat 7) dhe 9) fjalët: “Republika e Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: “Republika e Maqedonisë së Veriut”.

Pika 10) ndryshohet dhe bëhet:

“Personi shfrytëzues i ndihmës së garantuar minimale, i cili është person i paaftë për punë; shfrytëzues i kompensimit për shkak të pengesës; shfrytëzues i kompensimit për ndihmë dhe kujdes nga personi tjetër; personi me status të refugjatit të pranuar dhe person nën mbrojtje subsidiare; shfrytëzues i mbrojtjes jashtëfamiljare; personi-viktimë e dhunës familjare për të cilin ndërmerren masa të mbrojtjes në pajtim me rregullat nga sfera për parandalim, pengim dhe mbrojtje nga dhuna familjare; personi-viktimë e trafikim me njerëz; shfrytëzuesi i të drejtës së

sigurisë sociale për personat e moshuar, si dhe fëmijët me pengesa në zhvillim dhe me nevoja specifike për të cilin shfrytëzohet e drejta për shtesë të veçantë në pajtim me Ligjin e Mbrojtjes së Fëmijëve, nëse nuk mund të sigurohen në tjetër bazë”.

Në pikat 11), 12) dhe 15) fjalët: “Republika e Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: “Republika e Maqedonisë së Veriut”.

Neni 6

Në nenin 12 në paragrafin (1) në pikat 2) dhe 3) fjalët: “Republika e Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: “Republika e Maqedonisë së Veriut”.

Neni 7

Në nenin 13 në paragrafin (1) në pikat 3), 3-a) dhe 4) fjala “Maqedonia” zëvendësohet me fjalët: “Republika e Maqedonisë së Veriut”.

Në pikën 6) fjalët: “Republika e Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: “Republika e Maqedonisë së Veriut”.

Në pikat 7) dhe 15) fjala: “Maqedonia” zëvendësohet me fjalët: “Republika e Maqedonisë së Veriut”.

Neni 8

Në nenin 14 në paragrafin (1) në pikën 4) fjalët: “të hyrat, përkatësisht të hyrat neto të përcaktuara në mënyrë paushalle në të cilat paguhet tatim, në pajtim me Ligjin e Tatimit Personal mbi të Ardhurat” zëvendësohen me fjalët: “të ardhurat, përkatësisht të ardhurat neto të përcaktuara në mënyrë paushalle në të cilat paguhet tatim, në pajtim me Ligjin e Tatimit mbi të Ardhurat Personale”.

Në pikat 5), 6) dhe 13) nënpikat 1 dhe 2 fjalët: “Republika e Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: “Republika e Maqedonisë së Veriut”.

Në pikën 14) nënpika 2 ndryshohet dhe bëhet:

“Personi shfrytëzues i ndihmës së garantuar minimale, i cili është i paaftë për punë; shfrytëzues i kompensimit për shkak të pengesës; shfrytëzues i kompensimit për ndihmë dhe kujdes nga personi tjetër; personi me status të refugjatit të pranuar dhe personi nën mbrojtje subsidijare; shfrytëzues i mbrojtjes jashtë-familjare; personi-viktimë e dhunës familjare për të cilin ndërmerret masa e mbrojtjes në pajtim me rregullat nga sfera për parandalim, pengim dhe mbrojtje nga dhuna familjare; personi-viktimë e trafikimit me njerëz; shfrytëzuesi i të drejtës së sigurisë sociale për personat e moshuar, si dhe fëmijë me pengesa në zhvillim dhe me nevoja specifike për të cilin shfrytëzohet e drejta për shtesë të veçantë në pajtim me Ligjin e Mbrojtjes së Fëmijëve, ndërsa nuk mund të sigurohen në tjetër bazë”.

Në paragrafin (3) fjalët: “Republika e Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: “Republika e Maqedonisë së Veriut”.

Neni 9

Në nenin 15 paragrafët (1) dhe (2) dhe në nenin 16 paragrafët (4) dhe (5) fjalët: “Republika e Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: “Republika e Maqedonisë së Veriut”.

Neni 10

Në nenin 21 në paragrafin (1) fjalët: “tatimi personal mbi të ardhura” zëvendësohen me fjalët: “tatimi mbi të ardhura personale”.

Neni 11

Neni 28 ndryshohet dhe bëhet:

“(1) Gjobë në shumë prej 300 deri 1.000 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet obliguesit për përlllogaritje dhe pagesë të kontributeve-person juridik (mikro tregtar), prej 600 deri 2.000 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet obliguesit për përlllogaritje dhe pagesë të kontributeve – person juridik (tregtar i vogël), prej 1.800 deri 6.000 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet obliguesit për përlllogaritjen dhe pagimin e kontributeve – person juridik (tregtar i mesëm) dhe prej 3.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet obligues për përlllogaritje dhe pagesë të kontributeve – person juridik (tregtar i madh) për kundërvajtje, nëse vepron në kundërshtim me nenin 22 paragrafin (1) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 100 deri 250 euro në kundërvlerë denari obliguesit për përlllogaritje dhe pagesë të kontributeve – tregtar individ dhe personit, i cili në mënyrë të pavarur kryen veprimtari, do t’u shqiptohet për kundërvajtjen sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 50 deri 250 euro në kundërvlerë denari obliguesit për përlllogaritje dhe pagesë të kontributeve – person fizik do t’i shqiptohet për kundërvajtjen sipas paragrafit (1) të këtij neni”.

Neni 12

Neni 28-a ndryshohet dhe bëhet:

“(1) Gjobë në shumë prej 300 deri 1.000 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet obliguesit për përlllogaritje dhe pagesë të kontributeve-person juridik (mikro tregtar), prej 600 deri 2.000 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet obliguesit për përlllogaritje dhe pagesë të kontributeve – person juridik (tregtar i vogël), prej 1.800 deri 6.000 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet obliguesit për përlllogaritjen dhe pagesën e kontributeve – person juridik (tregtar i mesëm) dhe prej 3.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet obliguesit për përlllogaritje dhe pagesë të kontributeve – person juridik (tregtar i madh) për kundërvajtje, nëse:

- në mënyrë të parregullt e përgatit përlllogaritjen dhe pagesën e kontributeve i kryen në shumë të gabuar dhe

- vepron në kundërshtim me nenin 18 të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 100 deri 250 euro në kundërvlerë denari obliguesit për përlllogaritje dhe pagesë të kontributeve – tregtar individ dhe person i cili në mënyrë të pavarur kryen veprimtari, do t’u shqiptohet për kundërvajtjen sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 50 deri 250 euro në kundërvlerë denari obliguesit për përlllogaritje dhe pagesë të kontributeve – person fizik do t’i shqiptohet për kundërvajtjen sipas paragrafit (1) të këtij neni”.

Neni 13

Neni 28-b ndryshohet dhe bëhet:

“(1) Gjobë në shumë prej 300 deri 1.000 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet obliguesit për përlllogaritje dhe pagesë të kontributeve-person juridik (mikro tregtar), prej 600 deri 2.000 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet obliguesit për përlllogaritje dhe pagesë të kontributeve – person juridik (tregtar i vogël), prej 1.800 deri 6.000 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet obliguesit për përlllogaritjen dhe pagesën e kontributeve – person juridik (tregtar i mesëm) dhe prej 3.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet obligues për përlllogaritje dhe pagesë të kontributeve – person juridik (tregtar i madh) për kundërvajtje, nëse kryen pagesë të rrogës, pjesë të rrogës, kompensim të rrogës, pensionit, përkatësisht kompensim tjetër me para, ndërsa nuk përlllogarit dhe paguan kontribute në afatin e përcaktuar.

(2) Gjobë në shumë prej 50 deri 250 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet personit përgjegjës tek obliguesi për përlllogaritje dhe pagesë të kontributeve-person juridik (mikrotregtar), prej 100 deri 500 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet personit përgjegjës

tek obliguesi për përlllogaritje dhe pagesë të kontributeve – person juridik (tregtar i vogël), prej 150 deri 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek obliguesi për përlllogaritjen dhe pagimin e kontributeve – person juridik (tregtar i mesëm) dhe prej 200 deri 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek obliguesi për përlllogaritje dhe pagesë të kontributeve – person juridik (tregtar i madh) për kundërvajtjet sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 100 deri 250 euro në kundërvlerë denari obliguesit për përlllogaritje dhe pagesë të kontributeve – tregtar individ dhe person i cili në mënyrë të pavarur kryen veprimtari, do t'u shqiptohet për kundërvajtjen sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(4) Gjobë në shumë prej 50 deri 250 euro në kundërvlerë denari obliguesit për përlllogaritje dhe pagesë të kontributeve – person fizik do t'i shqiptohet për kundërvajtjen sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(5) Për kundërvajtjet sipas paragrafit (1) të këtij neni personit përgjegjës në personin juridik, tregtar individ dhe person i cili në mënyrë të pavarur kryen veprimtari, mund t'u shqiptohet sanksion kundërvajtës ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës në kohëzgjatje prej së paku tri ditësh deri më së shumti 30 ditë. Nëse kundërvajtjet sipas paragrafit (1) të këtij neni janë bërë për herë të parë, ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës, nëse shqiptohet, do të shqiptohet vetëm si sanksion i pavarur pa gjobë, ndërsa gjatë kryerjes së sërishme të kundërvajtjeve sipas paragrafit (1) të këtij neni, ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës, nëse shqiptohet, do të shqiptohet së bashku me gjobë”.

Neni 14

Në nenin 28-ç lidhëza “dhe” zëvendësohet me presje, ndërsa pas fjalës: “individ” vihet presje dhe shtohen fjalët: “personi fizik, person i cili në mënyrë të pavarur kryen veprimtari dhe person përgjegjës në personin juridik”.

Neni 15

Pas nenit 28-ç shtohet neni i ri 28-d dhe bëhet:

“Neni 28-d

Për kundërvajtjet nga ky ligj për të cilat gjoba është përcaktuar më së shumti deri në 250 euro në kundërvlerë denari për person fizik, tregtar individ dhe personin, i cili në mënyrë të pavarur kryen veprimtari, 500 euro në kundërvlerë denari për personin përgjegjës në personin juridik dhe 1.000 euro në kundërvlerë denari për persona juridik, procedurë kundërvajtëse dhe sanksione kundërvajtëse shqipton organi kundërvajtës.

(2) Për kundërvajtjet nga ky ligj për të cilat gjoba për personat sipas paragrafit (1) të këtij neni, është përcaktuar mbi shumat sipas paragrafit (1) të këtij neni, procedurë kundërvajtëse dhe sanksione kundërvajtëse shqipton gjykata kompetente”.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga botimi në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.